



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-037

Prishtinë, më 18 tetor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, Kabineti i Kryetarit

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 18 TETOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Burim Ramadani, Myzejene Selmani dhe Duda Balje.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Bilall Sherifi dhe Skender Reçica,

Nga Administrata e Kuvendit: Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha dhe Shefqet Rexhepi.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri pika shtesë.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 tetor 2011,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 tetor 2011

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 10 tetor 2011, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen e ardhshme plenare

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet të premtën, më 21 tetor 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e duhanit,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-034 për shtetësinë e Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për partneritet publiko - privat,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta,

10. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Punë të Jashtme për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës,
11. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për qasje në dokumente publike,
12. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për transfer të mjeteve në mes të programeve buxhetore,
13. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor për transfer të mjeteve në mes programeve buxhetore,
14. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.
15. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDK-së, për zëvendësimin e anëtarit të Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Kërkesa e Grupit Parlamentar të LDK-së për seancë të veçantë për të diskutuar lidhur me Raportin e Progresit 2011 për Kosovën, nga Komisioni Evropian

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Grupit Parlamentar të LDK-së, vendosi që Kuvendi të mbajë seancë të veçantë, më **27 tetor 2011**, me këtë pikë të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar lidhur me Raportin e Progresit 2011 për Kosovën.

3.2 Kërkesa e ish-deputetes së Kuvendit të Kosovës, Dritë Maliqi, lidhur me datën e përfundimit të mandatit të ish-deputetëve të Kuvendit

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Mandati i deputetëve të Legjislaturës III ka përfunduar ditën e certifikimit të deputetëve të Legjislaturës IV nga KQZ-ja, më 7 shkurt 2011.
2. Kërkohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që, në bashkëpunim me Administratën e Kuvendit, të rishikojë dhe rekomandojë sigurimin e mjeteve shtesë buxhetore, për kompensimin e pagës kalimtare për deputetët e Legjislaturës III, të cilët nuk janë deputetë të kësaj legjislature.

3.3 Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar në Lodër, Britani e Madhe

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Xhavit Haliti dhe Petar Miletqi, që të marrin pjesë në Seminarin e 78-të të NATO-s, që do të mbahet në Londër, Mbretëri e Bashkuar, prej 20-23 nëntor 2011.
2. Të gjitha shpenzimet për të lartpërmendurit në paragrafin (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3.4 Kërkesa e Komisionit për Legjislacion për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet nga Komisioni për Legjislacion që, në bashkëpunim me Komisionin parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë, ta hartojë Agjendën e vizitës dhe përbërjen e pjesëmarrësve në këtë vizitë.
2. Kërkesa, pas kompletimit të Agjendës dhe Programit të vizitës, t'i riprocedohet Kryesisë së Kuvendit, për miratim.

3.5 Njoftimi i Komisionit për Punë të Jashtme lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Republikën e Shqipërisë

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Punë të Jashtme, të realizuar në Republikën e Shqipërisë, më 29-30 shtator 2011.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën 11:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.